



Breaking News:

Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Bulevardi”



22/10/2025

Tiranë/Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Bulevardi”

Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Bulevardi”.

Lëvizte në bulevardin “Bajram Curri”, me pistoletë në automjet, arrestohet nga shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, 39-vjeçari.

Sekuestrohet arma e zjarrit me krehër dhe fishekë.

Në vijim të operacioneve policore, kundër armëmbajtjes pa leje, të zhvilluara si rezultat i punës së mirorganizuar operacionale dhe informative, shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 1, finalizuan operacionin “Bulevardi”.

Në bazë të informacioneve të siguruara, në bulevardin “Bajram Curri”, u ndalua automjeti tip “Benz” me drejtues shtetasin I. G., 39 vjeç, banues në Tiranë. Gjatë kontrollit, u gjet në automjet, 1 armë zjarri pistoletë me municion, të cilët 39-vjeçari e posedonte pa leje.

Në vijim të veprimeve procedurale për rastin, shtetasi I. G. u arrestua në flagrancë, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit”.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

> Arkiva

> Akademia e Sigurisë

> Ministria e Brendshme

> Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

> Interpol

> Europol

> Misioni PAMECA V

> SCPA

> Projekti Trivalent